



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.37/2021**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.37/2021 të datës 29.01.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë Komuna e Shtimes, kundër organit të punësimit Komuna e Shtimes, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datën 05.03.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**HEDHET** poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.37/2021, e datës 29.01.2021 e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja, e punësuar në Komunën e Shtimes sipas Akt emërimit me numër Nr.02/1/32/1 të datës 05.02.2013 në pozitën “Certifikuese”, me datë 28.01.2021 përmes emailit zyrtar [ankesa.kpmsack@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmsack@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është protokolluar me datë 29.01.2021, me numër protokollit 348/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 02.02.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Komunën e Shtimes. Më datë 12.02.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Shtimes, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 348/2021 të datës 29.01.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për harmonizimin e koeficientit e datës 05.05.2020; Përgjigjen në kërkesën e datës 05.05.2020, e datës 22.09.2020; Ankesën e ankueses

e datës 06.10.2020; Përgjigja në ankesën e ankueses e datës 15.10.2020; Shkresa e DASHC/MAP Nr.6038, e datës 27.11.2014; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit Nr.02/1/32/1 e datës 05.02.2013; Kërkesa për përgjigje e datës 02.02.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 12.02.201; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës për ankuesen i datës 24.02.2011; Pliko postare R 8790759 e datës 10.02.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa A.nr.37/2021 e datës 29.01.2021, e parashtruar nga ankuesja *është e pa lejuar, sepse:*

Ankuesja, me datë 29.01.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin që t'iu bëhet harmonizimi i koeficientit sipas vendimit të DASHC/MAP Nr.6038 të datës 27.11.2014.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës, ka gjetur se ankuesja sipas akt emërimit Nr.02/1/32/1 të datës 05.02.2013 është e punësuar në pozitën "Certifikuese", në Komunën e Shtimes, e cilët me datë 05.05.2020 i është drejtuar me kërkesë Zyrës së Personelit në Komunën e Shtimes, për harmonizimin e koeficientit. U.D. Menaxheri i Personelit i Komunës së Shtimes, me datë 22.09.2020, i kthen përgjigje në kërkesën e ankueses të datës 05.05.2020, me të cilin e ka informuar ankuesen se ka ndryshuar baza ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës për nëpunësit civil, pasi që tani është në fuqi Ligji për Zyrtarët Publik, dhe se kërkesa e ankueses për harmonizim të koeficientit nuk mund të realizohet. Ankuesja e pakënaqur me përgjigjen e datës 22.09.2020, e dhënë nga U.D. Menaxheri i Personelit i Komunës së Shtimes, me datë 06.10.2020 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes. Zyra e Personelit e Komunës së Shtimes më datë 15.10.2020, i kthen përgjigje në ankesën e ankueses ku thekson se: *"... Ju njoftojmë se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06L- 144 për Zyrtarët Publik, duke iu referuar nenit 24, paragrafit 3, nëse pretendoni se u janë shkelur të drejtat që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të paraqitni ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës".*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, bazuar në nenin 50 dhe nenin 81 paragrafi 2 nen paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020, si dhe nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht kërkesën e datës 05.05.2020 drejtuar Zyrës së Personelit si dhe ankesën e datës 06.10.2020 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Komunës së Shtimes, Kolegji



për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se parashtrimi i ankesës nga ankuesja me datë 29.01.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në piken 1 të këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.37/2021**

*Hysni Mustafa*  
  
**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**  
  
**Kryetare e Kolegjit**



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Shtimes dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

